



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"



Bazuar në nenin 48, paragrafi 1.8, dhe nenin 49, paragrafi 1, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Senati i UHZ-së, në mbledhjen e mbajtur më 14.02.2018, miraton:

Rregulloren për themelimin dhe parimet e trupës këshill-dhënëse të Njësive Akadematike të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.

Neni 1 - Qëllimi

Kjo rregullore e përcakton themelimin, fushëveprimin, parimet e funksionimit dhe organizimin e Trupës Këshill-dhënëse (në tekstin e mëtejme TK) të Njesisë Akadematike (në tekstin e mëtejme NJA) të Universitetit të "Haxhi Zeka" të Pejës. TK-ja është jo fitimprurës dhe ka rol këshillëdhënës dhe bazohet në vullnetin e mirë të anëtarëve dhe përkushtimin e NJA-ve dhe UHZ-së për ngritjen e cilësisë së Arsimit të Lartë në fushën e veprimtarisë së NJA-së.

Neni 2 – Themelimi

1. TK-në e themelon NJA përkatëse me propozimin e Dekanit, pas konsultimit me menaxhmentin e UHZ-së.
2. Dekanët e NJA-së në bashkëpunim me menaxhmentin e UHZ-së i propozojnë anëtarët e TK-së, emërimin e të cilëve e miraton Këshilli i NJA-së.
3. Dekani i NJA-së në konsultim me menaxhmentin e UHZ-së, e përgatitë mbledhjen konstitutive të TK-së, përpilon materialet lidhur me rendin e ditës dhe përgatitë aktivitete të mbarëvajtjes së punës së TK-së.
4. Pas themelimit të TK dhe zgjedhjes së kryetarit të TK-së, mund të propozohen edhe anëtarë tjerë të TK-së, dhe për zgjedhjen e tyre, Dekani e informon Këshillin e NJA-së.

Neni 3 – Parimet

TK për funksionimin e saj, do të sigurojë respektimin e parimeve dhe standardeve më të larta profesionale, të përcaktuara, midis të cilave:

1. Vullnetarizmi – anëtarët e TK-së, punën në TK e kryejnë pa ndonjë shpërblim.
2. Jodiskriminimi – anëtarët e TK-së trajtohen njësojë, duke respektuar standardet më të larta njerëzore dhe profesionale.
3. Përgjegjshmëria - anëtarët e TK-së, japin llogari për punën dhe veprimet e tyre.
4. Integriteti personal dhe profesional – anëtarët e TK-së janë me cilësi të larta morale dhe profesionale.
5. Besueshmëria – anëtarët e TK-së, janë të përkushtuar ndaj misionit dhe vizionit të UP-së.

Neni 4 – Anëtarësia

1. TK mund të ketë së paku njëmbëdhjetë (11) anëtarë deri në më së shumti nëntëmbëdhjetë (19) anëtarë. Numri i anëtarëve duhet të jetë tek dhe së paku 65% e anëtarëve të TK-së duhet të jenë nga tregu i punës.
2. TK përbëhet nga përfaqësues të tregut të punës që janë udhëheqës/vendim-marrës në kompani private apo publike, si dhe përfaqësues të autoriteteve qeveritare relevante për fushë-veprimtarinë e NjA-së, së caktuar, dhe një student i regjistruar në NjA, me sukses të mirë akademik, dhe që së paku të jetë në semestrin e tretë të studimeve.
3. Anëtarë *ex-officio* të TK-së, janë: dy anëtar nga menaxhmenti i UHZ-së, Dekani i NjA-së dhe Zyrtari ligjor i NjA-së. TK-ja mund të ketë jo më shumë se 4 (katër) anëtarë *ex-officio* të cilët janë pjesë e TK-së, pa të drejtë vote.
4. Anëtarët e TK-së, përveç nëse kanë qenë paraprakisht të angazhuar në mësim, nuk mund të angazhohen si ligjërues në NjA-në, pasi të jenë nominuar si anëtarë të TK-së.
5. Secili anëtar, përfaqësues i tregut të punës që shërben në TK, do të nënshkruajë Marrëveshjen e Mirëkuptimit.

Neni 5 - Zgjedhja e anëtarëve

1. Komisioni për zgjedhjen e anëtarëve të TK-së, përbëhet prej tre (3) anëtarëve të TK-së, dy (2) nga anëtarët, që nuk janë të interesuar të nominohen dhe Zyrtari ligjor.
2. Në qoftë se, të gjithë anëtarët e TK-së nominohen atëherë Komisioni përbëhet nga një anëtar i Menaxhmentit të UHZ-së, Dekanit dhe Zyrtarit ligjor.
3. Anëtarët e TK-së mund të nominojnë vetën apo ndonjë anëtarë tjetër.
4. Nomini bëhet sipas formularit (Shtojca 1), që dërgohet me postë elektronike, deri në tri (3) ditë para mbajtjes së takimit.
5. Zyrtari ligjori i NjA-së, përgatitë fletë-votimet me emrat e anëtarëve të nominuar.

6. Në takim duhet të jenë të pranishëm së paku 50%+1 e anëtarëve që kanë të drejtë vote, dhe që e kanë nënshkruar Marrëveshjen e Mirëkuptimit me rektorin e UHZ-së.
7. Të gjithë anëtarët e pranishëm votojnë vetëm për një anëtar të nominuar.
8. Zgjedhja e Kryetarit dhe Zëvendës-Kryetarit të TK-së, bëhet me votim të fshehtë.
9. TK e zgjedhë Kryetarin dhe Zëvendës-kryetarin nga radhët e përfaqësuesve të tregut të punës.
10. Në qoftë se dy ose më shumë anëtarë kanë numër të barabartë të votave, votimi përsëritet dhe votohen vetëm anëtarët që kanë numrin e barabartë të votave.
11. Anëtari i nominuar që e ka fituar numrin më të madh të votave zgjedhet Kryetar i TK-së, ndërsa anëtari i dytë me rradhë zgjedhet zëvendës kryetar.

Neni 6 - Roli dhe përgjegjësitë

1. TK mund t'i sugjerojë menaxhmentit të UHZ-së, respektivisht Këshillit të NjA-së përditësimin e programeve të studimeve, për të siguruar që studentët marrin përgatitjen e duhur profesionale, në përputhje me kërkesat e tregut.
2. Anëtarët e TK-së mund të mbështesin realizimin e praktikës profesionale të studentëve të NjA-së, në pajtim me programet e studimeve dhe mund të vlerësojnë rezultatet e të nxënit të studentëve, nëse kërkohet.
3. Trupa këshillëdhënëse mbështet NjA-në dhe tregun e punës të fushë veprimtarisë përkatëse, në krijimin e grupeve të përbashkëta punuese.
4. Trupa këshillëdhënëse dhe NjA bashkëpunojnë, në fushën e kërkimeve shkencore, shërbimeve profesionale, ndërmjetësimeve për inovacione, si dhe në propozime për bashkëpunim në projekte të përbashkëta me NjA-në dhe partnerë tjerë.
5. Anëtarët e TK-së mund të jenë mysafirë ligjërues për NjA-në përkatëse, ofrojnë bursa për studentë si dhe përkrahje financiare për projekte hulumtuese të studentëve dhe personelit akademik.
6. Anëtarët e TK-së mund të jenë anëtarë të komisionit për shpërndarjen e bursave për studentë dhe/ose vlerësojnë arritjet e studentëve nëse një gjë e tillë kërkohet nga Njësia Akadematike
7. Trupa këshillëdhënëse varësisht prej veprimtarisë së NjA-së mund të shqyrtojnë edhe çështje tjera të propozuara nga menaxhmenti i UHZ-së dhe kërkesës së Dekanit të NjA-së.
8. Me ftesën e Dekanit dhe menaxhmentit të UHZ-së, Kyetari i TK-së mund të prezantojë para Këshillit të NjA-së dhe para Agjencionit të Kosovës për Akreditim (AKA) aktivitetet e TK-së për periudhën e caktuar, apo kërkesat për programe të reja studimore apo përmirësimin e programeve ekzistuese.

9. Në rastet e akreditimit dhe ri-akreditimit të programeve të studimeve, nëse Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) kërkon takim me Kryetarin e TK-së, kryetari i TK-së do të takohet me ekspertët e AKA-së pas konsultimit me dekanin e NJA-së dhe /apo menaxhmentin e UHZ-së.

Neni 7 – Mandati i anëtarëve

1. Anëtarët e TK-së, do të shërbejnë në mënyrë aktive dhe profesionale, së paku dy (2) vite.
2. Anëtarët e TK-së, mund të rizgjedhen edhe për një mandat, bazuar në interesin e anëtarëve dhe kontributin e dhënë në NJA.
3. Kryetari i TK-së, udhëheqë me një mandat dy (2) vjeçar, me mundësi për edhe një mandat tjetër, përmes ri-zgjedhjes.
4. Zëvendës Kryetari i TK-së, zgjedhet për një mandat 3 (tre) vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes.

Neni 8 - Propozimet dhe këshillat e TK-së

1. Propozimet dhe këshillat për çështjet e caktuara, TK ia drejton Këshillit të NJA-së, menaxhmentit të UHZ-së, Senatit të UHZ-së dhe Këshillit Drejtues të UHZ-së.
2. Trupa këshillëdhënëse mund të sugjerojë ndryshimin, përmirësimin dhe amendamentimin e rregulloreve të UHZ-së dhe akteve tjera në fuqi.
3. Trupa këshillëdhënëse mund t'i propozojë Këshillit të NJA-së dhe menaxhmentit të UHZ-së, programe që kanë të bëjnë me mësimin tërë-jetësor, aftësimin e të rriturve dhe për trajnime profesionale.
4. Trupa këshillëdhënëse bënë vlerësime, rekomandime e sugjerime lidhur me kushtet e punës, laboratorët dhe lehtësimin e funksionalizimit të punës.
5. Këshillat dhe sugjerimet e TK-së për çështjet e trajtuara, midis të cilave, hartimin e programeve të reja, aplikimin për procesin e akreditimit, caktimin e punës praktike, planifikimin e projekteve kërkimore-shkencore, vlerësimin e tyre, dhe hartimin e dokumenteve strategjike, i drejtohen Këshillit të NJA-së, menaxhmentit të UHZ-së, Senatit të dhe Këshillit Drejtues të UHZ-së.

Neni 9 – Miratimi

1. Miratimi i propozimeve të TK-së bëhet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm.
2. Rekomandimet e Trupës Këshillëdhënëse, në formë të propozimit dorëzohen në Këshillin e NJA-së për procedim të mëtutjeshëm për te menaxhmenti i UHZ-së.

3. Menaxhmenti i UHZ-së dhe Këshilli i NJA-së i shqyrton propozimet për ndryshime të programeve akademike apo për programe të reja, dhe në afat prej tridhjetë (30) ditëve, ia ofron Kryetarit të TK-së, përgjigjen dhe arsyetimin për vendimin e nxjerrë.

Neni 10 - Takimet

1. TK do të mbajë deri në (4) takime të rregullta gjatë vitit, që mund të thirren nga secili anëtar.
2. Cilido anëtarë i TK-së mund të thërrasë takime, duke dërguar kërkesë me shkrim, me çështjen e specifikuar përmes postës elektronike, dhe i drejtohet Kryetarit të TK-së.
3. Kryetari i TK-së, e cakton takimin në konsultim me Dekanin e NjA-së/ose menaxhmentin e UHZ-së.
4. Zyrtari ligjor i NjA-së, në emër të Kryetarit e përgatitë ftesën me rendin e ditës, dhe e dërgon tek të gjithë anëtarët e TK-së, së paku shtatë (7) ditë para mbajtjes së takimit.
5. Për mbajtjen e takimit të TK-së, nevojitet kuorumi, apo numri i më shumë se gjysmës së anëtarëve të pranishëm.
6. Për të siguruar mbarëvajtjen e takimeve të TK-së, Dekani i NjA-së, emëron Zyrtarin ligjor të NjA-së, i cili përveç që është anëtar, të jetë përgjegjës dhe t'i ofrojë mbështetje Kryetarit të TK-së.
7. Zyrtari ligjor i NjA-së është përgjegjës për organizimin e takimeve të TK-ve, bën përmbledhjen e raporteve të punës së TK-së, arkivimin e dokumenteve dhe vendimeve, operacionalizimin e iniciativave të tij, publikimin e aktiviteteve të TK-së, dhe aktivitete tjera të nevojshme për të funksionalizuar dhe promovuar punën e TK-së.
8. Në takimet e TK-së, për çështje të caktura, ftohen, por nuk kanë të drejtë vote, edhe Shefat e departamenteve, Drejtori i institutit të NjA-së, Udhëheqësi i Qendrës së Karrierës në UHZ apo NjA, si edhe përfaqësues të organeve përkatëse në kuadër të NjA-së.
9. Kryetari i TK-së do t'i udhëheqë takimet e TK-së, dhe do të kujdeset që informatat të shpërndahen tek të gjithë anëtarët dhe palët e interesit sipas nevojës.
10. Në qoftë se Kryetari i tanishëm dështon që të organizojë takimet e TK-së dhe/ose mungon në dy takime me rradhë, TK shpallë zgjedhjet për Kryetar të ri.
11. Kryetari i TK-së, në bashkëpunim me Dekanin e NjA-së, raporton në Zyrën për Sigurimin e Cilësisë së Rektoratit të UHZ-së.
12. Për çdo takim të mbajtur, bëhet procesverbali përfshirë listat dhe vendimet e nxjerra nga TK.

Neni 11 – Përjashtimi nga funksioni i Anëtarit

1. TK e përjashton anëtarin e saj nga ushtrimi i funksionit, atëherë kur anëtari,
 - i. nuk i respekton vendimet e UHZ-së dhe TK-së.
 - ii. nuk i ushtron përgjegjësitë e caktuara të punës.
 - iii. nuk merr pjesë në së paku tri (3) takime të njëpasnjëshme të TK-së.
 - iv. nuk i respekton dispozitat e kësaj rregullore, dhe rregulloreve të UHZ-së.
 - v. nuk vepron në përputhshmëri me Kodin e Etikës, së UHZ-së.
2. Lloji dhe kohëzgjatja e masës për përjashtim, vendoset me shumicën e thjeshtë të votave, të anëtarëve të pranishëm.

Neni 12 - Përfaqësimi i TK-së

1. Në raport me palën e tretë TK-në e përfaqëson Kryetari, dhe në mungesë të kryetarit, përfaqësimin e bën zëvendës kryetari.
2. Kryetari i TK-së e prezanton punën e TK-së në organizime të ndryshme, para Këshillit të NjA-së, institucioneve të arsimit të lartë brenda vendit dhe jashtë vendit, në punëtori tematike dhe aktivitete të ngjashme.

Neni 13 – Publikimi

1. Aktivitetet e TK-së, publikohen në ueb faqen e UHZ-së, nën vegzën e NjA-së.
2. Përgjegjës për publikimin e aktiviteteve që janë të nevojshme për të funksionalizuar TK-të, dhe promovuar punën e tyre, në ueb faqe është Zyrtari ligjor i NjA-së.

Neni 14 - Procedurat në zhvillim e sipër

1. Procedurat e TK-së që janë në zhvillim e sipër në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë sipas dispozitave që kanë qenë në fuqi në atë kohë.
2. Mandati i anëtarëve të TK-ve që janë themeluar me Rregulloren e datës 29 dhjetor 2014 për këtë periudhë kalimtare do të mbetet katër (4) vjet, me mundësi të ri-zgjedhjes edhe për një mandat tjetër dy (2) vjeçar.




Neni 15 - Hyrja në fuqi


Me hyrjen ne fuqi te kësaj rregullore, shfuqizohet rregullorja Ref.nr. 1519, dt.23.06.2015 .
Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Senatit të UHZ-së.




Prof.Dr.Fadil Millaku


Rektor i Universitetit "Haxhi Zeka"
në Pejë





Shtojca 1. Formulari për nominimin e kryesuesit të TK-së

 UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET "HAXHI ZEKA"	
Emri i Anëtarit të TK-së	
Emri i Anëtarit që e nominoni	
Cilësitë e Anëtarit të nominuar	
Arsyeja pse e nominoni? Si mund të kontribuoj në TK	


8.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"**

Senate

Ref. 1907

Datë: 30.07.2018

**REGULATION on the Establishment and Functioning of the Advisory
Body of the Academic Units of "Haxhi Zeka" University in Peja**

Pursuant to Article 48, paragraph 1.8, and Article 49, paragraph 1 of the Statute of Haxhi Zeka University in Peja, the Senate, at its meeting on 01/04/2015, approved:

REGULATION on the Establishment and Functioning of the Advisory Body of the Academic Units of "Haxhi Zeka" University in Peja

Purpose

This regulation defines the character, membership, functioning, the scope, manner of decision making and mandate of the Advisory Panel.

Article 1

1. The character of the Advisory Body (hereinafter referred to as AB), established under the Statute of "Haxhi Zeka" University in Peja (hereinafter HZU) and this Regulation, is non-profit and advisory and is based on the goodwill of members and the commitment of Academic Units (hereinafter AU) and UHZ to enhance the quality of Higher Education in the area of AU activity.
2. The Advisory Body is composed of representatives of the labor market, the HZU authorities and the relevant AU field.
3. The composition and activities of the TMP are published on the UHZ-NI official website.

Article 2

1. The advisory body is established by the UHZ, for the respective AU on the proposal of the management.
2. The Advisory Body may have at least 11 members.
3. Management in collaboration with the AU Deans nominate the members of the Advisory Body, whose designation is approved by the AU Council and then approved in the Senate.
4. Following the constitution of the Advisory Body and the election of the President, other members of the Advisory Body may be proposed. For their selection, the management of HZU and AU informs the AU Council.

Article 3

1. The advisory body consists of labor market representatives who are decision makers in private or public companies as well as representatives of government authorities relevant to the field of activity of the respective AU.
2. Ex-officio members of the Advisory Body may be a member of the management and a member of the HZU AU.
3. The Management of the HZU and the management of AU prepares the constituent meeting of the Advisory Body, compiles the agenda items and undertakes other activities for the smooth running of the Advisory Body's work.

Article 4

1. The Advisory Body elects the President from among the representatives of the labor market. The Advisory Body Chairman conducts the meetings and ensures that information about the meetings is disseminated to all its members and other stakeholders.
2. According to this guideline and good and transparent practice, the Advisory Body Chairman ensures the collection of AB work reports and operationalization of its initiatives and informs the

management of reports after meetings.

3. The President of the Advisory Team represents the AB in relation to the third party. In the absence of the mayor, he must appoint a deputy.
4. The President of the Advisory Body presents the work of the AB in various organizations, such as: Council of AU, higher education institutions at home and abroad, thematic workshops, etc.
5. The advisory body may set up working groups focusing on specific areas of the AU scope of the relevant labor market.
6. Depending on the topics for discussion, the Heads of Departments, the relevant Institute Director of the AU and representatives of the relevant bodies acting within the AU, but without the right to vote in cases of voting, may be invited to the Advisory Body meetings.

Article 5

1. The advisory body may recommend to the University, namely the AU Council, the update of study programs according to labor market requirements.
2. AB members support the realization of the professional practice of AU students, in accordance with the study programs.
3. The Advisory Body supports the AU and the labor market in the field of work in the creation of common working groups.
4. The advisory body and AU cooperate in research, professional services, project collaborations, innovation mediation, as well as in collaborative project proposals with AU and other partners.
5. AB members can provide scholarships for students as well as financial support for student research projects and academic staff.
6. The advisory body may also consider other issues proposed by management at the request of the AU.

Article 6

1. The advisory body may suggest changing, improving and amending the regulations and other applicable acts.
2. The advisory body may propose to the HZU management and the AU Council programs related to: lifelong learning, adult training and vocational training.
3. The advisory body makes assessments, recommendations and suggestions regarding working conditions, laboratories and facilitating work functionality.
4. The AB's advice and suggestions on the issues addressed will be addressed to management, the AU Council, the HZU Senate, and the HZU Steering Council, in the context of: new program development, application for the process of accreditation, assignment of practical work, planning of research projects, their evaluation, drafting of strategic documents, etc.

Article 7

1. Proposals shall be approved by a simple majority of the members present.
2. The Advisory Panel's recommendations, in the form of a proposal, shall be submitted to the AU Council for further action in the management of HZU.

Article 8

1. The term of the members of the AB shall be four (4) years, with the possibility of re-election. The number of seats is not limited.

2. Upon management's invitation, the President of the AB may present the activities of the AB to the AU Council for the specified period.
3. AB membership is open regardless of race, gender, sexual orientation, citizenship, nationality, religion, age or physical ability.

Article 9

1. The term of members may end or be suspended by the decision of the AB or the management if:
 - They do not respect the decisions of the University.
 - do not actively participate in KT work,
 - do not comply with the provisions of the Regulation,
 - do not comply with the University Code of Ethics,
 - do not respect the decisions of the TC.
2. In case of suspension, the duration of the suspension shall be specified in the decision.
3. Termination or suspension of membership by the Assembly of Members shall be decided by a majority of the members of the AB present or by reasoning-decision of the management.

Article 10

In exercising their duties and responsibilities under this regulation, AB members must demonstrate an impartial, transparent decision-making in the best interest of the public and its confidence in public institutions, by preventing conflict between public interests and private ones according to the laws and regulations in force.

Article 11

1. This regulation shall enter into force upon signature by the Rector of UHZ.

Explanation: This regulation translated in English but signed and protocolled in Albanian.